

# PYETJE TE SHPESHTA KARTA E KREDITIT

## PERDORIMI I KARTES SE KREDITIT


### KU MUND TA PERDOR KARTEN TIME?

Karta juaj e kreditit mund të përdoret për të kryer lloje të ndryshme veprimesh brenda dhe jashtë vendit aty ku është e shfaqur logo MasterCard. Ju mund të kryeni pagesa në POS, tërheqje në ATM, blerje në internet (bileta avioni, rezervim hoteli, marrje me qera të makinave etj.), abonime në faqe të ndryshme online, etj. Pagesat në терминаlet POS mund të kryhen përmes CHIP & PIN, ose me teknologjinë më të fundit Contactless për pagesa në shuma të vogla.

### ÇFARE DO TE THOTE 'CONTACTLESS'?

Contactless është teknologjia më e fundit që shoqëron Kartat e Kreditit të Intesa Sanpaolo Bank Albania. Përmes saj, ju mund të realizoni pagesa pa e futur Kartën në terminalin POS. Mjafton që ju thjesht ta kaloni Kartën mbi të. Këto pagesa zakonisht realizohen pa futjen e kodit PIN dhe kanë një limit maksimal prej 2,000 Lek ose 2 veprime. Me arritjen e këtij limiti (vlerë ose numër), ju duhet të kryeni një veprim të suksesshëm me PIN për të mundësuar realizimin e veprimeve të tjera Contactless.

### KU MUND TA PERDOR MUNDESINE PER TE BERE VEPRIME CONTACTLESS?

Veprimet Contactless janë të mundura kudo ku përveç logos MasterCard, ju shikoni logon  në terminalin e pagesës. Përveç përdorimit jashtë Shqipërisë, këto lloj veprimesh janë të mundura edhe në Shqipëri në shumë POS të Intesa Sanpaolo Bank Albania si dhe të bankave të tjera vendase.